



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

*Dokument Parlamentar*

*Tiranë, më 11.06.2019*

**RAPORT**

**PËR**

**PROJEKTLIGJIN**

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.139/2015, “PËR VETËQEVERISJEN VENDORE””**

**- Hyrje**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjet e datave 29.01.2019 dhe 11.06.2019 mori në shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin z. Bashkim Fino.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit, ishin të pranishëm z. Pandeli Majko, Ministër Shteti për Diasporën dhe përfaqësues të kësaj ministrie si dhe përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

**I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Nga analiza e nenit 81, pika 2, të Kushtetutës dhe përmbajtjes konkrete të këtij projektligji, rezulton se fusha që rregullon ky projektligj përfshihet në çështjet që trajton kjo dispozitë kushtetuese, e për pasojë miratimi i këtij projektligji i nënshtrohet miratimit me shumicë të cilësuar<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit: a) ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve, të parashikuara nga Kushtetuta; b) ligji për shtetësinë; c) ligji për zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore; ç) ligji për referendumet; d) kodet; dh) ligji për gjendjen e jashtëzakonshme; e) ligji për statusin e funksionarëve publikë; ë) ligji për amnistinë; f) ligji për ndarjen administrative të Republikës.

## II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur si nismë e Këshillit të Ministrave, propozon disa shtesa dhe ndryshime në ligjin aktual nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Ligji “Për vetëqeverisjen vendore” ka vendosur një kuadër të ri rregullator dhe normativ për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, duke njohur funksionet dhe kompetencat e reja që i decentralizohen qeverisjes vendore si dhe organizimit dhe funksionimit sa më të mirë, pas reformës së thellë administrativo-territoriale. Ky ligj ka patur në themel të tij përcaktimin e qartë të funksioneve dhe kompetencave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore në kuadrin e thellimit të decentralizimit e të politikave të reja në këtë fushë.

Referuar relacionit shpjegues që shoqëron këtë nismë ligjore, propozimi i këtij projektligji synon nxitjen e politikave të bashkëpunimit e të ndërveprimit me të gjithë shqiptarët, duke nxitur dhe fuqizuar bashkëpunimin në të gjitha fushat me shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe shtetet ku ata banojnë.

Në këtë kontekst, ky projektligj propozohet në vazhdim të punës së ndjekur deri më tani për krijimin e infrastrukturës ligjore, ku përmendim ligjin nr.115/2017, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare për Diasporën”, ligjin nr.16/2018, “Për diasporën”, ligjin nr.32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, si edhe Strategjinë Kombëtare për Diasporën, të cilat mbështesin nga pikëpamja rregullatore zhvillimin e raporteve me diasporën, por që tashmë kjo infrastrukturë ligjore duhet të shtrihet edhe në nivel vendor.

## III. KONSULTIMI PUBLIK NË KUVEND I PROJEKTLIGJIT

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në kuadër të gjithëpërfshirjes, transparencës dhe konsultimit publik, bazuar në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë dhe ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, e dërgoi projektligjin për mendim pranë tre shoqatave të përfaqësuesve të interesave të pushtetit vendor përkatësisht pranë: Shoqatës për Autonominë Vendore, Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë dhe Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë.

Shoqata për Autonominë Vendore është shprehur pozitivisht për ndërmarrjen e kësaj nisme, duke vlerësuar njëkohësisht se projektligji përbën një hap shumë të rëndësishëm për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve për diasporën dhe migracionin, të cilat kanë munguar.

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë nuk ka paraqitur mendime shtesë në krahasim me sugjerimet e dhëna gjatë fazës së konsultimit të saj nga ministria propozuese, duke shprehur njëkohësisht angazhimin për hartimin e akteve të tjera nënligjore për të siguruar zbatimin në praktikë të kësaj nisme.

#### IV. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

Në prezantimin e bërë përpara Komisionit për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ministri përgjegjës për çështjet e diasporës parashtrroi se ky projektligj vjen si një propozim në kuadër të masave vazhduese të Qeverisë Shqiptare për ngritjen e infrastrukturës institucionale, të domosdoshme për zhvillimin e lidhjeve me diasporën dhe propozohet në vazhdim të paketës së akteve ligjore në fushën e diasporës.

Nga relatori u vlerësua ndërmjarrja e kësaj nisme ligjore e cila përbën vijimin e punës së bërë deri më tani për krijimin e kuadrit të nevojshëm ligjor e cila mbështet nga pikëpamja rregullatore e funksionale zhvillimin e raporteve me diasporën. Nisma ligjore synon promovimin e pjesëmarrjes së diasporës në jetën e vendit të origjinës, rikonfirmimin e rëndësisë që ka diaspora në ndërtimin e urave lidhëse me vendin e origjinës, veçanërisht në zhvillimin social-ekonomik, politik e kulturor të vendit të origjinës. Në këtë aspekt projektligji parashikon shtimin e një funksioni të ri të bashkive, pikërisht atë që lidhet me çështjet e diasporës dhe migracionit. Në kuadër të ushtrimit të këtyre funksioneve parashikohet që pranë çdo bashkie të krijohet në strukturë e posaçme për diasporën dhe migracionin. Ngritja e kësaj strukture vlerësohet se do të nxisë politikën e bashkëpunimit e të ndërveprimit dhe të përkrahjes së të gjithë shqiptarëve që jetojnë jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë.

Një çështje tjetër e diskutuar në Komision, lidhet me propozimin e bërë për ndryshimin e afatit të raportimit për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit, të njësive së vetëqeverisjes vendore, nga data 31 Mars e çdo viti në datën 31 Maj. Relatori sqaroi se ky ndryshim, pavarësisht se nuk është i lidhur me shtimin e funksioneve të bashkive në fushën e diasporës dhe migracionit, ka si qëllim:

- i. harmonizimin e ligjit të vetëqeverisjes vendore me parashikimet e bëra në ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili ngarkon Ministrin përgjegjës për financat për paraqitjen e buxhetit faktik të shtetit në Këshillin e Ministrave, brenda muajit Maj.
- ii. zbatimin e standardit të ri për mirëmenaxhimin e financave publike vendore të vendosur në ligjin “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, sipas të cilit, buxheti faktik i njësive vendore, përpara miratimit, duhet të certifikohet nga një audit i jashtëm që mund të jetë KLSH-ja ose një auditues ligjor. Në këtë kuadër, duke qënë se data e mbylljes së llogarive financiare është data 31 Mars e çdo viti financiar, është vlerësuar lënia e një afati në dispozicion të Bashkive për kryerjen e procedurave të certifikimit të buxhetit faktik, përpara paraqitjes së Këshillin Bashkiak.

Komisioni diskutoi edhe në lidhje me propozimin e paraqitur në nismën e Këshillit të Ministrave lidhur me përfshirjen e përfaqësuesve të diasporës, si kategori nëpërmjet të cilës zhvillohet procesi i konsultimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore për politikën dhe legjislacionin që ka ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të tyre. Lidhur me këtë propozim u vlerësua se parashikimi i bërë në nenin 12 të ligjit aktual nr. 139/2015 i jep të drejtën njësive të vetëqeverisjes vendore që nëpërmjet shoqatave përfaqësuese të tyre të konsultohen gjatë hartimit të nismave, politikave dhe legjislacionit që ka ndikim në

funksionet e qeverisjes vendore. Ky përcaktim është i lidhur me të drejtën e njërive të vetëqeverisjes vendore për t'u organizuar në shoqata (neni 9 i ligjit aktual).

Duke marrë në konsideratë faktin që tashmë janë konsoliduar dy shoqatat kryesore të cilat përfaqësojnë interesat e njërive të vetëqeverisjes vendore në tërësinë e funksioneve që kryhen prej tyre referuar neneve, përfaqësuesit e diasporës, në vlerësimin e komisionit nuk mund të identifikohen si grup interesi më vete duke referuar vetëm në një funksion të bashkive.

Në këtë aspekt Komisioni bazuar edhe në propozimin e relatorit vlereson si të panevojshëm ndryshimin e propozuar nga neni 2 i projektligjit.

Komisioni mori në shqyrtim edhe propozimin e paraqitur nga relatori dhe të mbështetur nga anëtarë të Komisioni lidhur me nevojën për kryerjen e një saktësimi në dispozitën që trajton kompetencat e Këshillit Bashkiak dhe vendimmarrjen e tij, në kuadër të ushtrimit të të drejtës së pronësisë të bashkive.

Ligji aktual "Për vetëqeverisjen vendore" bën një trajtim të njëjtë të së drejtës së njërive të vetëqeverisjes vendore për tjetërsimin e pronës e cila kalon tek të tretët, (me tjetërsim kalohen njëherazi tre tagrat e pronarit: i) e drejta e disponimit; ii) e drejta e gëzimit dhe iii) e drejta administrimit) me të drejtën për dhënien në përdorim të pronës nëpërmjet të cilës kalohen vetëm tagrat e administrimit, (qeraja, enfiteoza etj), por njëria vijon të gëzojë disponimin e saj. Gjithashtu edhe kuorumi i nevojshëm për realizimin e vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak në këto raste është përcaktuar të jetë e njëjtë, me shumicë të cilësuar me 3/5 e anëtarëve.

Ndërkohë që propozimi i paraqitur në komision dhe i miratuar prej tij, synon të bëjë një ndarje ndërmjet rastit të tjetërsimit të pronës së njërive të vetëqeverisjes vendore, ku kuorumi i nevojshëm vazhdon të mbetet me shumicë të cilësuar të anëtarëve të Këshillit Bashkiak, nga rasti i dhënies në përdorim dhe dhënies për zhvillim të pronës të tretëve, ku propozohet që kuorumi për vendimmarrje të Këshillit Bashkiak të jetë me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve. Kjo për arsye sepse tjetërsimi hyn tek te tagrat e jashtëzakonshme, ndërsa dhënia në përdorim është tagër e zakonshme.

Gjithashtu, propozimi shton dhe kompetencën për zhvillimin e pronës që nuk ka qënë parashikuar më parë në ligj, por që bëhet e nevojshme për shkak të dinamikës së zhvillimit infrastrukturor dhe urban të qyteteve, veçanërisht në dhjetëvjeçarin e fundit. E drejta për zhvillim e pronës, edhe pse është pjesë e tagrave të pronësisë, është e dallueshme nga e drejta e pronësisë dhe lidhet me planifikimin vendor për përdorimin e tokës. Pronari me ushtrimin e të drejtës për zhvillim nuk e tjetërson pronën, por në marrëveshje me pronarë të tjerë dhe/ose me subjekte të tjerë privatë bie dakort për zhvillimin e projekteve të përbashkëta duke rritur përfitimet e tij të ushtrimit të së drejtës së pronësisë mbi një pronë të caktuar.

#### **IV. PROPOZIME PËR RIFORMULIME NEN PËR NEN**

A. Preambula e projektligjit të riformulohet si më poshtë:

"Në mbështetje të neneve 13, 78, 81, pika 2, 83, pika 1, dhe 108 – 115 të Kushtetutës me propozimin e Këshillit të Ministrave, ..."

B. Në neni 1 të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- Në shkronjën “a” termi njësisë vendore” të zëvendësohet me termin “njësisë së vetëqeverisjes vendore”.
- Në shkronja “c” shprehja “...regjistrimin e fitimin e shtetësisë”, të zëvendësohet me shprehjen “...fitimin e shtetësisë shqiptare”.
- shkronja “ç” të riformulohet me këtë përmbajtje:  
*“ç) dhënien e ndihmës e të informacionit për të interesuarit nga diaspora dhe migracioni për legjislacionin shqiptar në fushën e investimeve, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për çështjet e investimeve”.*

**C. Neni 2** të hiqet.

**Ç. Pas nenit 3** të shtohen **nenet 3/1 dhe 3/2** me këtë përmbajtje:

*“Neni 3/1*

*Në nenin 54 bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:*

*1. Shkronja “e” ndryshohet me këtë përmbajtje:*

*“e) miraton tjetërsimin e pronave të tretëve”.*

*2. Pas shkronjës “e” shtohet shkronja “e/1 me këtë përmbajtje:*

*“e/1) miraton dhënien në përdorim të pronave të tretëve ose dhënien për zhvillim të pronës nëpërmjet bashkëpunimit me subjekte private ”*

*“Neni 3/2*

*Në nenin 55 pika 3, pas referencës në shkronjën “d” shtohet referenca në shkronjën “e/1”.*

**D.** Dispozita e hyrjes në fuqi të numërtohet.

## **V. PËRFUNDIME**

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

- a) *Në aspektin ligjor*, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- b) *Në aspektin procedural*, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e shumicës së anëtarëve të komisionit e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

**RELATOR**

**KRYETARI**

**BASHKIM FINO**

**ULSI MANJA**

